



**SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
KOSOVË**

**SOS FSHATRAT E
FËMIJËVE
KOSOVË**

Nr. i protokollit: 172

Data: 15.03.2020



**KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Pranuar me: Prilimjena:	<u>24.03</u>	<u>2021</u>
Njesia Jednica	Numri i-ri	Shtojca Dodatak
<u>1-560</u>	<u>16179</u>	

Aneks I i Marrëveshjes së bashkëpunimit

E nënshkruar me datë 15.03.2021 ndërmjet:

FONDACIONI SOS FSHATRAT E FËMIJËVE KOSOVË me numër të regjistrimit
5200200-1 dhe adresë në Rr. 1 Tetori p.n. Velania, 10000, Prishtinë, Kosovë

dhe

Qendra për Punë Sociale Lipjan në Rr. Avdi Kelmendi, Lipjan, Kosovë

Bazuar në Marrëveshje Bashkëpunimi për zbatimin e projektit “Rrugëtim i Sigurtë drejt të
Ardhmes” të mbështetur teknikisht dhe financiarisht nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë, të
lidhur mes palëve më datë 09.07.2020.

Meqë angazhimet e punonjëse të SOS Fshatrat e fëmijëve sipas Marrëveshjes së
Bashkëpunimit me Komunën e Lipjanit në ofrimin të shërbimeve për fëmijë dhe familje në
rrezik e në veçanti azilkërkuesit, refugjatët dhe migrantët në tejkalimin e sfidave me të
cilat ballafaqohen gjatë qëndrimit në Kosovë ndërlidhet me Marrëveshjen e Bashkëpunimit
të lidhur mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve më datë
13.11.2020 (që bashkëngjitet si Shtojca 1 e këtij Aneksi)

Me kërkesë të Komunës së Lipjanit për specifikimin e angazhimit të punonjësve të SOS
Fshatrat e fëmijëve sipas Marrëveshjeve të cituara më sipër

Palët pajtohet si në vijim :

Neni 1.

Neni II i Marrëveshjes së Bashkëpunimit do të plotësohet dhe ndryshojë si në vijim

Obligimet dhe përgjegjësitë e Fondacionit SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë janë si në
vijim:



1. Do të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në nenin I.1) të Marrëveshjes,
2. Do të ofrojë përkrahje profesionale dhe shkëmbimin e informatave për fushën e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve të marginalizuar, menaxhimin e rasteve, teknikat e punës me fëmijë dhe familje, përmes angazhimit të punonjësve sociale në Qendrën për Azil dhe Qendrën për Mbjajtje të të Huajve dhe Qendrën për Punë Sociale në Lipjan sipas orarit në vijim :
 - a. Në Qendrën për Azil çdo të Enjte dhe të Premte dhe
 - b. Qendrën për Mbjajtje të të Huajve sipas nevojës
 - c. Punëtorja sociale e angazhuar përmes kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të angazhohet në Qendër për Punë Sociale Lipjan çdo të Hënë, të Martë dhe të Mërkurë
3. Do të monitorojë dhe vlerësojë procesin e përfituesve duke përfshirë identifikimin e rasteve, referimin dhe intervenimin,
4. Të raportoj për rrjedhën e punës si dhe të bashkëveproj me të gjithë akterët relevant lokal.

Neni 2.

Të gjitha nenet tjera të Marrëveshjes të cilat nuk janë plotësuar / ndryshuar me këtë aneks zbatohet si në mënyrën e përcaktuar me Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Neni 3

Ky aneks hyn në fuqi me datë 15.03.2021

Për Komunën e Lipjanit

Z. Imri Ahmeti
Kryetar i Lipjan-it



Për Fondacionin SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Znj. Nezahat Salihu
Drejtor Nacional

